

# PROGRAMI PËR VLERËSIMIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE ME QËLLIM IDENTIFIKIMIN E NEVOJAVE PËR PËRMIRËSIM

---

## KLASAT I-IV TË ARSIMIT FILLOR




Gjuhë shqipe  
Matematikë

# TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES .....	1
HYRJE .....	2
KLASA I.....	4
Gjuhë shqipe (Abetare).....	4
Matematikë .....	5
KLASA II .....	9
Gjuhë shqipe.....	9
Matematikë .....	12
KLASA III.....	16
Gjuhë shqipe.....	16
Matematikë .....	19
KLASA IV.....	24
Gjuhë shqipe.....	24
Matematikë .....	27

# HYRJE

Institucionet arsimore në të gjithë botën janë duke u përballur me sfidat që solli pandemia COVID-19. I njëjti realitet është edhe në shkollat tona. Për të parandaluar përhapjen e virusit dhe për të siguruar shëndetin e mësuesve dhe të nxënësve, shkollat e realizuan procesin mësimor mbi bazën e orientimeve të dhëna në Udhëzuesin për fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Në këtë udhëzues parashikohen tre skenarë për zhvillimin e procesit mësimor:

-  mësim në shkollë;
-  mësim i kombinuar (në shtëpi dhe në shkollë);
-  mësim në kushtet e shtëpisë (online).

Këta skenarë janë zbatuar nga shkollat në varësi të infrastrukturës, të numrit të nxënësve dhe të situatës epidemiologjike. Mësimi në distancë ose i kombinuar ka bërë të mundur që pjesa më e madhe e nxënësve të vijojë normalisht me ndërtimin e njohurive dhe të aftësive lëndore. Megjithatë, ka patur nxënës që për arsye të ndryshme (kanë kaluar COVID-19, nuk kanë patur gjithmonë akses në internet, nuk ka qenë gjithmonë e mundur ndihma e prindërve, kanë nevojë për mbështetjen e mësuesit etj.), kanë patur vështirësi në këtë proces.

Për të identifikuar vështirësitë dhe nevojat e nxënësve do të realizohen disa testime vjetore në lëndët kryesore. Këto teste janë *diagnostikuese*, nuk vlerësohen me notë dhe kanë për qëllim vetëm identifikimin e nevojave të nxënësve në lidhje me njohuritë dhe aftësitë kryesore të programeve mësimore.

Në ARSIMIN FILLOR do të zhvillohen dy teste:

- Gjuhë shqipe dhe Matematikë (ky test do të jetë i përbashkët për të dyja lëndët)

Për të orientuar hartuesit e testeve, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave është hartuar programi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në lëndët “Gjuhë shqipe” dhe “Matematikë”. Këto lëndë zhvillojnë te nxënësit kompetencat më të rëndësishme, të cilat janë jo vetëm

kusht për nxënien e të gjitha lëndëve në shkollë, por edhe për suksesin në jetë dhe në tregun e punës. Hartimi i këtij programi është mbështetur në programet e gjuhës shqipe dhe të matematikës. Ai përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme që duhet të zotërojë nxënësi nga klasa I-IV.

Për lëndën e gjuhës shqipe, për secilën klasë, janë dhënë temat orientuese dhe udhëzime për tri kompetencat gjuhësore: *Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare, Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale dhe Përdorimi i drejtë i gjuhës*. Gjithashtu, janë dhënë dhe rezultatet e të nxëniet për konceptet kryesore të programit të gjuhës shqipe.

Përdoruesit e programit janë:

- specialistët e vlerësimit në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), të cilët do të bazohen në këtë program për hartimin e testeve nga klasa I-IV;
- mësuesit, të cilët do t'i përdorin rezultatet e testit për identifikimin e vështirësive të nxënësve dhe për planifikimin e punës në lidhje me përmirësimin e arritjeve;
- drejtuesit e shkollave, të cilët do të koordinojnë dhe do të monitorojnë procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe përmirësimin e nevojave të tyre;
- specialistëve dhe bashkëpunëtorëve të ASCAP për hartimin e udhëzuesit për orientimin e mësuesve të arsimit fillor lidhur me organizimin e procesit të përsëritjes dhe të përforcimit me synimin e përmirësimin të arritjeve të nxënësve.

# KLASA I

## Gjuhë shqipe (Abetare)

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
<b>Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare<sup>1</sup></b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Shkronjat e alfabetit (të mëdha e të vogla) dhe tingujt.</li><li>- Zanoret.</li><li>- Bashkëtingëlloret.</li><li>- Rrokja.</li><li>- Fjala.</li><li>- Tiparet dalluese të fjalisë (fillimi me shkronjë të madhe dhe shenja e pikësimit në fund).</li><li>- Njohuri të thjeshta për tiparet e teksteve.</li></ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon shkronjat e mëdha nga shkronjat e vogla, zanoret dhe bashkëtingëlloret;</li><li>- identifikon shkronjën e madhe, pikën, pikëpyetjen;</li><li>- bën dallimin midis përrallës, vjershës, tregimit dhe gjëgjëzës;</li><li>- tregon me disa fjali të thjeshta veprimet që kryen personazhi kryesor.</li></ul>
<b>Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale<sup>2</sup></b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Shkrimi i shkronjave të gjuhës shqipe.</li><li>- Shkrimi i fjalëve deri në trerrokëshe.</li><li>- Shkrimi i fjalisë dhe vendosja e shenjës së pikësimit në fund të saj.</li><li>- Shkrimi i një kartoline ose i një urimi sipas modeleve të dhëna.</li><li>- Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur</li></ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- shkruan fjalë një, dy dhe trerrokëshe;</li><li>- vendos shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën ose pikëpyetjen, në fundin e saj;</li><li>- shkruan deri në 3 fjali rreth një figureje të dhënë.</li></ul>

<sup>1</sup> Teksti në prozë mund të jetë përrallë, tregim ose poezi. Teksti joletrar mund të jetë rregull praktik, kartolinë ose letër e shkruar.

<sup>2</sup> Tema e të shkruarit mund të jetë përshkrim i thjeshtë i një fotografie, personazhi, një njeri të afërm, një shok ose kafshë shtëpiake, shkrimi i një kartoline, shkrimi i një urimi për një ditëlindje.

nga disa ilustrime.	
Përdorimi i drejtë i gjuhës <sup>3</sup>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fjalë, fjala, rrokja, tingulli.</li> <li>- Ndarja e fjalisë në fjalë.</li> <li>- Fjalët që tregojnë veprime (foljet).</li> <li>- Fjalët që tregojnë njerëz, sende, vende, kafshë (emrat).</li> <li>- Fjalët që tregojnë cilësi të njerëzve, të sendeve, të kafshëve (mbiemrat).</li> <li>- Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, në titullin e një pjese, tek emrat e njerëzve dhe të kafshëve.</li> <li>- Përdorimi i pikës dhe i pikëpyetjes në fund të fjalisë.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndan një fjali në fjalë;</li> <li>- plotëson rrokjen ose fjalën që mungon;</li> <li>- emërton njerëzit, kafshët dhe sendet;</li> <li>- zbaton shenjat e pikësimit në fjalitë e dhëna.</li> </ul>

## Matematikë

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Numri	
<p><b>Numri natyror</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numërimi i një grupi sendesh deri në 20, duke filluar nga cilido prej tyre.</li> <li>- Numërimi me nga 1, duke filluar nga çdo numër (jo më shumë se 100 numrat e parë).</li> <li>- Numërimi në rendin zbritës, duke filluar jo më shumë se 20.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon numrat tek dhe çift të dhjetëshes së parë.</li> <li>- zbërthen një numër dyshifror deri në 20 dhe anasjelltas.</li> <li>- krahason dy bashkësi të dhëna, dy numra duke përdorur shprehjet " më shumë se", "më pak se", "aq sa".</li> </ul>

<sup>3</sup> Temat për kompetencën "Përdorimi i drejtë i gjuhës" lidhen me njohuritë gjuhësore të programit.

- Numërimi me dhjetëshe të plota duke filluar nga një dhjetëshe e plotë (në rendin rritës dhe në rendin zbritës) deri në 100.
- Numri rreshtor (jo më shumë se 10 numra).

### **Krahasimi i numrave**

- Krahasimi i dy numrave dhe sendeve duke përdorur shprehjet “më shumë”, “më pak”, “po aq”.
- Gjetja e një numri ndërmjet dy numrave të dhënë deri në 20.
- Renditja.
- Gjysma e numrave njëshifrorë me mjete konkrete dhe ilustrime.

### **Mbledhja e zbritja**

- Mbledhja dhe zbritja e dy numrave njëshifrorë.

### **Shumëzimi dhe pjesëtimi**

- Dyfishimi i numrave njëshifrorë.
- Gjetja gjysmës së numrave çift (2,4,6,8,10) me anë të objekteve.

- gjen numrin ndërmjet dy numrave të dhënë deri në 20
- mbledh dhe të zbret dy numra njëshifrorë në fjali numerike
- gjen dyfishin e numrave njëshifrorë
- gjen gjysmën e numrave çift: 2, 4, 6, 8, 10.

## **Matja**

### **Gjatësia**

- Përdorimi i terminologjisë përkatëse

### **Nxënësi:**

<p>("më i gjatë", "po aq i gjatë", "më i shkurtër", "më i gjati", "më i shkurtri").</p> <p><b>Koha</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leximi i orës me orë të plota.</li> </ul> <p><b>Pesha</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdorimi i terminologjisë përkatëse ("më i rëndë", "më i lehtë", "po aq i rëndë", "më i rëndi", "më i lehti");</li> </ul> <p><b>Monedhat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Parashikimi i mundësisë për një blerje që lidhet me një sasi të caktuar lekësh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- krahason duke përdorur shprehjet "më i gjatë se", "më i shkurtër se", "po aq i gjatë";</li> <li>- lexon orët e plota;</li> <li>- krahason duke përdorur terminologjinë përkatëse ("më i rëndë", "më i lehtë", "po aq i rëndë", "më i rëndi", "më i lehti");</li> <li>- kryen parashikime të thjeshta se çfarë mund të blejë me monedha deri në 100-lekë.</li> </ul>
--	--

## Gjeometria

<p><b>Gjeometria në plan</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rrethi, katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi.</li> </ul> <p><b>Gjeometria në hapësirë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kubi, kuboidi, cilindër, kon, sferë</li> </ul> <p><b>Shndërrimet gjeometrike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendndodhja dhe termat: para, pas, mbi, nën, majtas, djathtas, ndërmjet etj</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon format 2D: rrethin, trekëndëshin, katrorin, drejtkëndëshin;</li> <li>- dallon format 3 D: kubin, kuboidin, cilindrin, konin dhe sferën;</li> <li>- dallon figurat simetrike;</li> <li>- tregon venndodhjen e tij ose të trupit të kërkuar duke përdorur shprehjet: "afër", "larg", "lart", "poshtë", "para", "pas", "mbi", "nën", "majtas", "djathtas".</li> </ul>
--	--



- Figura simetrike.

### Algebra dhe funksioni

#### Funksioni

Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli (vargu) konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie që ka të bëjë me ngjyrën, formën ose madhësinë.

#### Nxënësi:

- dallon ndryshimet brenda një vargu elementesh, figura ose numrash;
- vazhdon vargun pasi ka zbuluar ndryshimin dhe ligjësinë e përdorur brenda tij.

### Statistika dhe probabiliteti

#### Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave

- Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektesh, sipas një cilësie të përbashkët.

#### Nxënësi:

- grumbullon, zbulon ose klasifikon grup sendesh apo figurash në bazë të një cilësie të përbashkët (ngjyra, forma, trashësia etj.).

# KLASA II

## Gjuhë shqipe

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
<b>Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare<sup>4</sup></b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Njohuri të thjeshta e të përgjithshme për tiparet e:<ul style="list-style-type: none"><li>• përrallave;</li><li>• fabulave;</li><li>• tregimeve;</li><li>• poezive (p.sh., <i>shkruhen në vargje, strofa</i>).</li></ul></li><li>- Njohuri për elementet e teksteve, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu.</li><li>- Njohuri të thjeshta për elementet e një kalendarit, letre drejtuar një të afërmi, një kartoline (<i>frazat hyrëse, urimin dhe dërguesin e kartolinës etj.</i>).</li></ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara;</li><li>- dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu;</li><li>- lexon tekste joletrare si: ditar, kalendar i thjeshtë, kartolina, letra etj.;</li></ul>
<b>Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale<sup>5</sup></b>	
<ul style="list-style-type: none"><li>- Përshkrime të thjeshta të një pikturë ose të një fotografie.</li><li>- Përshkrim i thjeshtë i një personazhi.</li></ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe për një temë të caktuar);</li></ul>

<sup>4</sup> Teksti në prozë mund të jetë përrallë, fabul, tregim ose poezi. Teksti joletrar mund të jetë kalendar, kartolinë, letër drejtuar një të afërmi.

<sup>5</sup> Tema e të shkruarit mund të jetë diktim, përshkrim i thjeshtë i një pikturë ose fotografie, personazhi, një njeriu të afërm, një shok ose kafshë shtëpiake, rrëfim i një historie personale, shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga disa ilustrime, shkrimi i një kartoline, shkrimi i një letre të thjeshtë drejtuar një shoku ose një shoqeje, shkrimi i një urimi për një ditëlindje ose me rastin e një feste ose shkrimi i një plani të thjeshtë ditor.

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrime të thjeshta për një njeri të afërm, një shok ose një kafshë shtëpiake.</li> <li>- Rrëfimi i një historie personale (gjysmë faqe).</li> <li>- Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga disa ilustrime.</li> <li>- Shkrimi i një kartoline.</li> <li>- Shkrimi i një letre të thjeshtë drejtuar një shoku ose një shoqeje.</li> <li>- Shkrimi i një urimi për një ditëlindje ose me rastin e një feste.</li> <li>- Shkrimi i një plani ditor të thjeshtë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna;</li> <li>- përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi;</li> <li>- shkruan hyrje dhe mbyllje të tjera të një tregimi ose përralle;</li> <li>- përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të;</li> <li>- rrëfen histori e përvoja personale;</li> <li>- shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku duke përdorur një model të thjeshtë;</li> <li>- harton një plan të thjeshtë të regjimit ditor.</li> </ul>
---	--

### Përdorimi i drejtë i gjuhës<sup>6</sup>

<p><b>a) Sintaksë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fjalja dëftore dhe fjalja pyetëse (tregojmë ose pyesim).</li> <li>- Zhvendosje e fjalëve në fjali, pa e prishur kuptimin e saj.</li> </ul> <p><b>b) Morfologji</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohuri të thjeshta për emrin.</li> <li>- Gjinia e emrit (<i>në mënyrë intuitive</i>).</li> <li>- Numri i emrit (<i>në mënyrë intuitive</i>).</li> </ul>	<p><b>a) Sintaksë</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- formon fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit;</li> <li>- zhvendos fjalët në fjali, në mënyrë të tillë që të mos priset kuptimi i saj;</li> </ul> <p><b>b) Morfologji</b></p> <p>Nxënësi:</p>
---	--

<sup>6</sup> Temat për kompetencën "Përdorimi i drejtë i gjuhës" lidhen me njohuritë gjuhësore të programit.

).

### Folja

- Njohuri të thjeshta për foljen.
- Koha e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti kohë: *dje-sot-nesër*.
- Zgjedhimi i foljeve *kam* dhe *jam* në kohën e tashme.
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme, sipas modeleve të dhëna.

### Mbiemri

- Njohuri të thjeshta për mbiemrin, si fjalë që tregon cilësi të emrave.

### Përemri

- Përemri vetor.

### Numërori

- Numërori.

### c) Drejtshkrim

- Përdorimi i shenjave të pikësimit (pika dhe pikëpyetja në fund të fjalisë).

- dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore; numrin njëjës dhe numrin shumës;
- dallon kohën e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti kohë: *dje-sot-nesër*;
- zgjedhon foljet *kam*, *jam* në kohën e tashme;
- ndërton fjali me përemrat vetorë: *unë*, *ti*, *ai*, *ajo*, *ne*, *ju*, *ata*, *ato*;
- shkruan me fjalë numërorët 1-20;

### c) Drejtshkrim

#### Nxënësi

- përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën dhe pikëpyetjen në fund të fjalisë;
- përdor drejt shkronjën e madhe për emra njerëzish, vendesh dhe kafshësh;
- ndan si duhet fjalët në fund të rreshtit.

- Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë.
- Përdorimi i shkronjës së madhe për emrat e njerëzve, vendeve (qyteteve, fshatrave, shteteve) dhe kafshëve.
- Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit.
- Shkrimi i numërorëve nga 1 deri në 20.

## Matematikë

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
<b>Numri</b>	
<p><b>Numri natyror</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leximi dhe shkrimi i numrave, (të paktën) deri në 100.</li> <li>- Vendvlera dhe rendet.</li> <li>- Numrat çift dhe numrat tek.</li> <li>- Paraqitja e një numri dyshifror në trajtë të zberthyer.</li> </ul> <p><b>Krahasimi i numrave</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krahasimi i numrave dyshifrorë, duke përdorur simbolikën përkatëse.</li> <li>- Vlerësimi sasior (me sy) i një grupi sendesh.</li> </ul> <p><b>Thyesat</b></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton vlerën për secilën shifër në numrat dyshifrorë;</li> <li>- paraqet në trajtë të zberthyer një numër dyshifror duke i ndarë në dhjetëshe dhe njëshe;</li> <li>- identifikon figurat që janë ndarë në gjysëm ose një të katërtën dhe cilat jo;</li> <li>- mbledh dy numra dyshifrorë;</li> <li>- gjen ndryshesa të vogla të dy numrave dyshifrorë;</li> <li>- shkruan thyesa <math>1/2</math>; <math>1/4</math>; <math>3/4</math>;</li> <li>- njeh që <math>2/2</math> ose <math>4/4</math> bëjnë një e plotë;</li> <li>- kupton shumëzimin duke përshkruar një rreshtim;</li> </ul>

- E plota e shprehur në thyesë psh.  $2/2$  ose  $4/4$ .
- Njohuri fillestare për thyesa të barabarta psh.  $1/2$  dhe  $2/4$ .

### Mbledhja dhe zbritja

- Mbledhja dhe zbritja e një numri dyshifrorë me një shumëfish të 10.
- Mbledhja e një numri dyshifrorë me një numër njëshifror.
- Zbritja e një numri dyshifror me një numër njëshifror
- Mbledhja e dy numra dyshifrorë.
- Vetë të mbledhjes dhe zbritjes.

### Shumëzimi dhe pjesëtimi

- Shumëzimi me anë të rreshtimeve.
- Pjesëtimi si grupim.

- kupton pjesëtimin si grupim;

## Matja

### Gjatësia dhe masa

- Njësitë standarde (centimetri, metri, grami, kilogrami)

### Koha

- Ora, dita, java, muaji dhe viti, renditja e ditëve të javës dhe e muajve të vitit.

### Nxënësi:

- krahason gjatësitë dhe masën e dy sendeve duke përdorur njësitë standarde (centimetri, metri, grami, kilogrami);
- njeh njësitë e kohës (ora, dita, java, muaji dhe viti);
- llogarit shuma me monedha me çmime të sendeve nga jeta e tij e përditshme;

### Monedhat

- Llogaritja e blerjeve që lidhet me një sasi të caktuar lekësh (monedha).

### Vëllimi

- Krahasimi i vëllimit të lëngjeve në enë.

- krahason vëllimin e enëve të ndryshme të njohura për ta duke përdorur njësitë standarde (litrin).

## Gjeometria

### Gjeometria në plan

- Rrethi, katrori, drejtkëndëshi, pesëkëndëshi dhe gjashtëkëndëshi i rregullt.
- Vetitë e figurave.

### Gjeometria në hapësirë

- Kubi, kuboidi, cilindër, kon, sferë, piramidë.
- Vetitë e trupave.

### Shndërrimet gjeometrike

- Figura simetrike.
- Drejteza e simetrisë.

Nxënësi:

- përshkruan vetitë e formave 2D (katror, drejtkëndësh, rreth, pesëkëndësh dhe gjashtëkëndësh të rregullt) dhe të trupave 3D (kubi, kuboidi, koni, cilindri, sfera dhe piramida);
- dallon figura simetrike nga jeta e përditshme.

## Algjebra dhe funksioni

Nxënësi:

**Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve**

- Kutiza si vendmbajtëse numrash.

**Funksioni**

- Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie.

- gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime me mbledhje të dy numrave njëshifrorë me shumë deri në 20.
- përshkruan dhe vazhdon një model duke numëruar me dy dhe tre numra sipas një ligjësie;

**Statistika dhe probabiliteti**

**Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave**

- Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objktesh, sipas një ose dy cilësie të përbashkët;
- Grafikët në shtyllë dhe Piktogramet.

**Nxënësi:**

- përdor piktogramet për të prezantuar rezultatet;
- përdor diagramën e Venit për të klasifikuar numrat dhe objektet sipas një ose dy cilësive.



# KLASA III

## Gjuhë shqipe

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
<b>Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare<sup>7</sup></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krahasimi mes përrallës dhe fabulës.</li> <li>- Brendia ose përmbajtja e një teksti.</li> <li>- Struktura e tekstit letrar (hyrja, zhvillimi, mbyllja).</li> <li>- Personazhet e tekstit.</li> <li>- Koha dhe mjedisi ku zhvillohen ngjarjet.</li> <li>- Elementet pamore të teksteve: fotografitë, ilustrimet (<i>funksionet e tyre</i>).</li> <li>- Struktura e tekstit joletrar.</li> <li>- Tipare të thjeshta të një udhëzimi, porosie, flete ditari.</li> <li>- Titulli, nëntitujt, ndarja në paragrafë e një teksti.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- u përgjigjet pyetjeve <i>Kush? Çfarë? Kur? Ku? Pse?</i> në lidhje me ngjarjet që ndodhin në tregim, përrallë, fabul;</li> <li>- tregon pjesën që i pëlqen më shumë dhe është më e këndshme për të;</li> <li>- dallon hyrjen, zhvillimin dhe fundin e një historie, përralle, tregimi etj.;</li> <li>- krahason tregimin me përrallën dhe me fabulën (tiparet kryesore të tyre).</li> <li>- dallon temën ose idetë kryesore në tekstet jo letrare;</li> <li>- analizon strukturën e një teksti jo letrar.</li> </ul>
<b>Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale<sup>8</sup></b>	
<p><b>Të shkruarit për qëllime personale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrime të njerëzve të dashur, të</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p>

<sup>7</sup> Teksti në prozë mund të jetë poezi e thjeshtë, gjëegjëzë, fabul, përrallë ose tregim. Teksti joletrar mund të jetë revistë për fëmijë, udhëzim i thjeshtë, porosi dhe fletë ditari.

<sup>8</sup> Tema e të shkruarit mund të jetë *dikttime, përshkrim i njerëzve të dashur, i heronjve të preferuar të librave ose të filmave, i natyrës, i lojërave për fëmijë etj., shkrime hyrjesh ose mbylljesh të tjera të përrallave ose tregimeve të lexuara, rrëfime të subjektit të një filmi ose libri, shkrime historish, urimesh, kartolinash, letrash falenderimi, ftesa për ditëlindje, planesh të thjeshta për veprimtari me klasën.*

<p>heronjve të preferuar të librave ose të filmave, të natyrës, të lojërave etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkrime hyrjesh ose mbylljesh të tjera të përrallave ose tregimeve të lexuara.</li> <li>- Shkrime historish duke u mbështetur në disa fotografi ose në fjalë kyç.</li> </ul> <p><b>Të shkruarit për qëllime funksionale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësime modelesh (tekste) gjysmë të gatshme.</li> <li>- Shkrime urimesh, kartolinash, letrash falënderimi, ftesash për ditëlindje.</li> <li>- Shkrime planesh të thjeshta (p.sh., për një veprimtari me klasën).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shkruan duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre;</li> <li>- zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit;</li> <li>- përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat, mendimet dhe paraqitjen e jashtme të tyre;</li> <li>- shkruan një hyrje ose një mbyllje ndryshe të një tregimi, përralle etj.;</li> <li>- shpreh me shkrim ndjenjat dhe përjetimet që i ngjall një poezi/tregim.</li> </ul>
--	--

### Përdorimi i drejtë i gjuhës<sup>9</sup>

<p><b>a) Sintaksë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teksti (<i>C'quajmë tekst dhe elementet e tij: fjalitë, paragrafët</i>).</li> <li>- Struktura e një fjalie të thjeshtë.</li> <li>- Zhvendosja e fjalëve ose e grupeve të fjalëve në fjali, pa e prishur kuptimin e saj.</li> </ul>	<p><b>a) Sintaksë</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon fjalitë dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse;</li> <li>- ndërton fjali pohore dhe fjali mohore;</li> <li>- heq, shton ose zhvendos fjalë në fjali, pa e prishur kuptimin e saj;</li> <li>- dallon kryefjalën e shprehur me emër;</li> </ul>
---	---

<sup>9</sup> Temat për kompetencën "Përdorimi i drejtë i gjuhës" lidhen me njohuritë gjuhësore të programit.

- Shtim ose heqje fjalësh apo grupe fjalësh në fjali, pa e prishur kuptimin e saj.
- Fjalja mohore dhe fjalja pohore.
- Fjalja dëftore dhe fjalja pyetëse.
- Fjalja nxitëse dhe fjalja dëshirore.

## **b) Morfologji**

### **Emri**

- Emri, çfarë emërton (njohuri të përgjithshme).
- Emrat e gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore nisur nga mbaresat e tyre.
- Emrat në numrin njëjës dhe në numrin shumës.
- Emrat në trajtën e shquar dhe në trajtën e pashquar.

### **Folja**

- Folja, çfarë tregon (njohuri të përgjithshme).
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme.
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e ardhme.
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e pakryer.

- dallon kallëzuesin dhe tregon me çfarë është shprehur;

## **b) Morfologji**

- dallon emrat konkretë dhe emrat abstraktë;
- përcakton trajtën e emrit
- zgjedhon në kohën e tashme, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme foljet e rregullta;
- përshtat mbiemrin me emrin që shoqëron;
- dallon përemrat vetorë;
- dallon në fjali numërorin.

## **c) Drejtshkrim**

- shkruan saktë pjesëzat mohuese *nuk* dhe *s'* në fjali;

## **ç) Leksikologji dhe semantikë**

- krijon çifte sinonimie dhe antonimie.

### Mbiemri

- Mbiemri si fjalë që tregon cilësi të emrit që shoqëron.
- Mbiemri i nyjshëm dhe mbiemri i panyjshëm.

### Përemri

- Përemri vetor.

### Numërori

- Numërori si fjalë që tregon sasi

### c) Drejtshkrim

- Përdorimi i shenjave të pikësimit ., ?, !.
- Shkrimi i pjesëzave mohuese *nuk* dhe *s'*.

### ç) Leksikologji dhe semantikë

- Sinonimet dhe antonimet.

## Matematikë

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
<b>Numri</b>	
<b>Numri Natyror</b>	Nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"><li>- Vendvlera e secilës shifër në numrat treshifrorë.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- krahason dy numra treshifrorë duke përdorur simbolet e krahasimit &lt; dhe &gt;;</li></ul>

- Shumëfishimi i një numri dyshifrorë me 10.
- Krahasimi i dy numrave treshifrorë duke përdorur simbolet e krahasimit < dhe >.

### **Thyesat**

- Koncepti i thyesës për të shprehur pjesë të së tërës, (psh.  $\frac{3}{4}$  tre të katërtat).
- Thyesat e barabarta.
- Numrat e përzierë si:  $1\frac{1}{2}$  apo  $2\frac{1}{4}$ .

### **Mbledhja dhe zbritja**

- Mbledhja dhe zbritja e dy numrave dyshifrorë.
- Mbledhja dhe zbritja e një numri treshifrorë me një numër njëshifrorë.

### **Shumëzimi dhe pjesëtimi**

- Shumëfishimi i një numri dyshifrorë me 10.
- Tabela e shumëzimit me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe 10 dhe pjesëtimi si veprim i anasjelltë.
- Pjesëtimi si veprim i kundërt i shumëzimit.

- shumëfishon një numër dyshifrorë me 10;
- mbledh dhe zbret dy numra dyshifrorë;
- përdor konceptin e thyesës për të shprehur pjesë të së tërës, (psh.  $\frac{3}{4}$  tre të katërtat);
- njeh numra të përzierë si:  $1\frac{1}{2}$  apo  $2\frac{1}{4}$ ;
- mbledh dhe zbret dy numra dyshifrorë
- mbledh dhe zbret një numër treshifrorë me një numër njëshifror;
- kupton mbetjen gjatë pjesëtimit.

- Mbetja gjatë pjesëtimit, (mbeten edhe disa për t'u ndarë).

## Matja

### Gjatësia dhe masa.

- Njësiti standarde: km, m, cm ora, kg, g.
- Këmbime me njësi të ndryshme.

### Paraja

- Monedhat, deri në 1000-lekëshe.
- Kombinime monedhash që tregojnë të njëjtën vlerë në lekë.

### Koha

- Njësiti e kohës sekonda, minuta, ora, dita, muaji, viti.
- Matja e kohës deri në 5 minutëshin më të afërt;
- Renditja e ngjarjeve.

### Vëllimi

Litri, mililitri.

### Nxënësi:

- njeh lidhjen ndërmjet kilometrit dhe metrit, metrit dhe centimetrit, kilogramit dhe gramit, litrit, mililitrit;
- përdor veprime (mbedhje dhe zbritje) me përdorimin e parave;
- përdor njësiti e kohës dhe marrëdhënien ndërmjet tyre (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti);
- lexon orën me akrepa në 5 minutëshin më të afërt;
- fillon të llogarisë intervale të thjeshta në orë dhe minuta.
- njeh lidhjen ndërmjet litrit dhe mililitrit

## Gjeometria

### Gjeometria në plan

- Katrori, drejtkëndëshi, pesëkëndëshi, gjashtëkëndëshi,

### Nxënësi:

- përshkruan disa forma 2D në bazë të numrit të brinjëve e kulmeve;

<p>tetëkëndëshi, gjysëm rrethi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vetitë e figurave.</li> <li>- Këndi i drejtë</li> </ul> <p><b>Gjeometria në hapësirë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kubi, kuboidi, cilindër, kon, sferë, prizmi, piramida.</li> <li>- Vetitë e trupave.</li> </ul> <p><b>Shndërrimet gjeometrike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Figura simetrike.</li> <li>- Drejtëza e simetrisë.</li> <li>- Lëvizja, pozicioni, drejtimi orar dhe kundërorar.</li> <li>- Rrjeta e katrorëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- krahason kënde me këndin e drejtë</li> <li>- emërton trupat 3D (kubi, kuboidi, koni, cilindri, sfera, prizmi dhe piramida)</li> <li>- plotëson një figurë sipas një drejtëze simetrie;</li> <li>- përdor instruksione për pozicionet me drejtim orar ose kundërorar;</li> <li>- përdor rrjetin e katrorëve për të vizatuar kënde të drejtë.</li> </ul>
<b>Algebra dhe funksioni</b>	
<p><b>Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kutiza si vendmbajtëse numrash.</li> </ul> <p><b>Funksioni</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime me mbledhje ose me zbritje, të dy numrave njëshifrorë me shumë deri në 100;</li> <li>- vazhdon një model duke numëruar me dhjetëshe.</li> </ul>
<b>Statistika dhe probabiliteti</b>	
<p><b>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të</b></p>	<p>Nxënësi:</p>

## **dhënave**

- Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektesh, sipas një ose dy cilësive të përbashkët;
- Grafikët në shtyllë dhe piktogramet.

- grumbullon të dhëna në një listë ose tabelë.
- përdorimi i diagramës së Venit për të klasifikuar numrat dhe objektet sipas një ose dy cilësive



# KLASA IV

## Gjuhë shqipe

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
<b>Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare<sup>10</sup></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Renditja e ngjarjeve në një tekst.</li> <li>- Analiza e personazheve (<i>tiparet e jashtme, veprimet, ndjenjat</i>).</li> <li>- Rima dhe strofa në poezi (<i>dallimi i rimës dhe i strofës</i>).</li> <li>- Tiparet kryesore të një përralle, fabule dhe tregimi.</li> <li>- Tiparet kryesore të një ditari/udhëzimi.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon tiparet e jashtme, veprimet, ndjenjat e personazheve;</li> <li>- dallon rimën, strofën, vargun në një poezi;</li> <li>- identifikont tiparet kryesore të një përralle, fabule dhe tregimi;</li> <li>- dallon temën ose idetë kryesore në një tekst joletrar.</li> </ul>
<b>Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale<sup>11</sup></b>	
<b>Të shkruarit për qëllime personale</b>	Nxënësi:
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrime të shokëve, artistëve ose sportistëve të preferuar etj.</li> <li>- Rrëfime ngjarjesh rreth botës reale dhe imagjinare, si p.sh.: për pushimet, për librat, për universin, për anijet kozmike etj.</li> <li>- Përshkrime të thjeshta personazhesh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan një individ (shok, artist ose sportist të preferuar);</li> <li>- shkruan një ngjarje reale ose imagjinare;</li> <li>- përshkruan personazhe librash dhe filmash;</li> <li>- përshkruan natyrën duke përdorur krahasimin;</li> <li>- shkruan një ftesë për miqtë;</li> </ul>

<sup>10</sup> Tekste në prozë mund të jenë *poezi të thjeshta, fabula, përralla, tregime, anekdota, gjëgjëza* etj. Tekstet joletrare mund të jenë *fletë ditari, letra, shkrime në revista për fëmijë, enciklopedi për fëmijë ose udhëzime të thjeshta*.

<sup>11</sup> Temat e të shkruarit mund të jenë: diktime, përshkrime të shokëve, artistëve ose sportistëve të preferuar etj., rrëfime ngjarjesh rreth botës reale dhe imagjinare, përshkrime të thjeshta personazhesh, shkrime ftesash për miqtë dhe shokët, hartimi i regjimit ditor, i një plani javor të thjeshtë.

### Të shkruarit për qëllime funksionale

- Shkrime ftesash për miqtë dhe shokët.
- Hartimi i regjimit ditor.
- Hartimi i një plani javor të thjeshtë.

- harton një plan ditor dhe javor.

## Përdorimi i drejtë i gjuhës<sup>12</sup>

### a) Sintaksë

- Grupet kryesore të fjalëve në fjali.  
Veprime me grupet kryesore të fjalëve në fjali.
- Kryefjala, njohuri të përgjithshme.
- Kallëzuesi, njohuri të përgjithshme.
- Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën.

### b) Morfologji

#### Emri

- Emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm.
- Gjinia e emrit.
- Numri i emrit.
- Lakimi emrit.

#### Mbiemri

- Gjinia dhe numri i mbiemrit.
- Lakimi i mbiemrave sipas rasave.

Nxënësi:

### a) Sintaksë

- ndërton drejt fjali, duke pasur si bazë fjalën si njësi leksiko-gramatikore, logjikën e thënies, intonacionin e përfunduar;
- identifikon dy grupet kryesore në fjali;

### b) Morfologji

- analizon emrin sipas kategorive gramatikore i përgjithshëm/i përveçëm/gjinia/ numri/ trajta dhe rasa;
- analizon mbiemrin sipas kategorive gramatikore të gjinisë/numrit/rasës;
- dallon përemrin vetor/përemrin pronor/ ndajfoljen;

<sup>12</sup> Temat për kompetencën "Përdorimi i drejtë i gjuhës" lidhen me njohuritë gjuhësore të programit.

## **Përemri**

- Përemri pronor.
- Përemri vetor.

## **Folja**

- Zgjedhimi i foljeve *kam* dhe *jam* në kohën e tashme, të pakryer dhe të kryer të thjeshtë, në mënyrën dëftore.
- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme, të pakryer dhe të kryer të thjeshtë, në mënyrën dëftore.

## **Ndajfolja**

- Ndajfolja (njohuri të përgjithshme).

## **c) Drejtshkrim**

- Shenjat e pikësimit në dialog.
- Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë, në emrat e njerëzve, emrat e përveçëm të kafshëve, emrat e vendeve.
- Përshtatja e mbiemrit të nyjshëm me emrin që plotëson.

## **ç) Leksikologji dhe semantikë**

- Sinonimet dhe antonimet.
- Fjalët me shumë kuptime

- zgjedhon foljet e rregullta në kohën e tashme, të pakryer dhe të kryer të thjeshtë, në mënyrën dëftore.

## **c) Drejtshkrim**

- drejtshkruan një dialog duke përdorur (:) dhe (-);
- drejtshkruan fjalët mohuese/pohuese;
- përdor saktë shkronjën e madhe në fillimet e fjalive dhe tek emrat e përveçëm;

## **ç) Leksikologji dhe semantikë**

- dallon kuptimin e figurshëm të fjalëve.

## Matematikë

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
<b>Numri</b>	
<p><b>Numrat natyror, dhjetorë dhe të plotë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rrumbullakimi i numrave treshifrorë në dhjetëshen ose qindëshen më të afërt.</li> <li>- Krahasimi i dy numrave treshifrorë duke përdorur simbolet e krahasimit <math>&lt;</math> dhe <math>&gt;</math>.</li> </ul> <p><b>Thyesat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krahasimi i dy thyesave me emërues të njëjtë.</li> <li>- Thyesa të barabarta.</li> <li>- Barazimi i thyesave me numrat dhjetorë me një shifër mbas presjes.</li> </ul> <p><b>Mbledhja dhe zbritja</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledhja e dy numrave treshifrorë.</li> <li>- Zbritja e një numëri dyshifrorë nga një numër treshifrorë.</li> <li>- Zbritja e dy numra treshifrorë.</li> </ul> <p><b>Shumëzimi dhe pjesëtimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shumëzimi i numrave dyshifrorë me numër njëshifrorë.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kupton vlerën dhe vendvlerën e secilës shifër te numrat tre-katërshifrorë;</li> <li>- krahason dy numra tre duke përdorur simbolet <math>&lt;</math> dhe <math>&gt;</math>;</li> <li>- rrumbullakon numrat treshifrorë në dhjetëshen dhe qindëshen më të afërt;</li> <li>- shkruan një thyesë dhjetore si një numër dhjetor me një shifër pas presjes;</li> <li>- krahason dy thyesa me emërues të njëjtë;</li> <li>- formon thyesa të barabarta me shumëzim ose me pjesëtim;</li> <li>- tregon thyesat e barabarta me një numër dhjetor me një shifër pas presjes;</li> <li>- mbledh dhe zbret dy numra treshifrorë;</li> <li>- shumëzon dy numra dyshifrorë me një numër njëshifror;</li> <li>- shumëzon dhe pjesëton numrat treshifrorë me 10 (rezultati është numër natyror).</li> <li>- pjesëton numrat dyshifrorë me numër një shifrorë (përgjigja jo më e madhe se 20);</li> <li>- zgjidh situata problemore duke përdorur veprimet dhe algoritmin e tyre;</li> </ul>

- Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave treshifrorë me 10.
- Shumëzimi i numrave dyshifrorë me 100 .
- Pjesëtimi i numrave dyshifrorë me numër një shifrorë (përgjigja jo më e madhe se 20);

## Matja

### Gjatësia dhe masa

- Njësitë standarde: km, m, cm, mm,kg, g.
- Këmbime me njësi të ndryshme.

### Koha

- Njësitë e kohës sekonda, minuta, ora, dita, muaji, viti.
- Matja e kohës deri në minutin më të afërt;
- Kalendari.
- Tabela e orareve intervalet.

### Perimetri dhe syprina

- Drejtkëndëshi dhe perimetri i tij.
- Sipërfaqja e drejtkëndëshit në një rrjet katrorësh.

### Vëllimi

### Nxënësi:

- këmben njësi standarde të matjes së gjatësisë, masës, vëllimit të lëngjeve;
- lexon dhe tregon kohën në minutën më të afërt në orën me akrepa;
- përdor sistemin 12 orësh për të treguar orën;
- njehson perimetrin e drejtkëndëshit;
- gjen sipërfaqen e drejtkëndëshit të vizatuar në një rrjet katrorëshë
- njeh lidhjen ndërmjet litrit dhe mililitrit

Litri, mililitri.

## Gjeometria

### Gjeometria në plan

- Katrori, drejtkëndëshi, pesëkëndëshi, gjashtëkëndëshi, shtatëkëndëshi, tetëkëndëshi, gjysëm rrethi.
- Vetitë e figurave.

### Gjeometria në hapësirë

- Kubi, kuboidi, cilindër, kon, sferë, prizmi, piramida.
- Vetitë e trupave.

### Shndërrimet gjeometrike

- Figura simetrike.
- Drejtëza e simetrisë.
- Lëvizja, pozicioni, drejtimi orar dhe kundërorar.
- Rrjeta e katrorëve.

Nxënësi:

- klasifikon shumëkëndëshat sipas brinjëve, këndeve dhe boshteve të simetrisë
- identifikon drejtëzat e simetrisë në figurat 2D dhe në modele të thjeshta;
- identifikon pozicionin e një katrori në një rrjet katrorësh.

## Algjebra dhe funksioni

### Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve

- Kutiza si vendmbajtëse numrash.

### Funksioni

Nxënësi:

- gjen numrin që duhet të vendosë në një kutizë në barazim me mbledhje (me shumë deri 1000) dhe me zbritje.

- Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie.

### Statistika dhe probabiliteti


#### Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave

- Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektesh, sipas një ose dy cilësive të përbashkët.
- Digramat në shtyllë dhe Piktogramet.
- Intervalet në diagramet në shtyllë.
- Diagrami i Venit.

#### Nxënësi:

- përdor piktogramën, tabelën e dendurive, diagramën shtyllë për të prezantuar rezultatet;
- përdor intervalet me 2,5, 10 ose 20 njësi në diagramën shtyllë.

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



---

Rruga "Naim Frashëri"  
Nr. 37  
Tiranë  
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

*sekretaria@ascap.edu.al*

*www.ascap.edu.al*